

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 5-2021

PJESËMARRJA DHE ROLI I GRAVE KOSOVARE NË POLITIKË

Alisa Thaqi

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Political Science Commons](#)

Recommended Citation

Thaqi, Alisa, "PJESËMARRJA DHE ROLI I GRAVE KOSOVARE NË POLITIKË" (2021). *Theses and Dissertations*. 2680.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/2680>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.



Kolegji UBT
Fakulteti i Shkencave Politike

**PJESËMARRJA DHE ROLI I GRAVE KOSOVARE NË
POLITIKË**

Alisa Thaqi

Maj, 2021

Prishtinë



Universiteti për Biznes dhe Teknologji
Fakulteti: Shkenca Politike dhe Administratë Publike

PUNIM DIPLOME

Viti 2015 – 2016

Alisa Thaqi

PJESËMARRJA DHE ROLI I GRAVE KOSOVARE NË POLITIKË

Mentori: Prof. Dr. Ruzhdi Matoshi

Maj, 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Bachelor

Abstrakt

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje i kontribon proceseve pozitive transformuese për shoqëritë, siç janë ndryshimet e ligjeve, politikave, shërbimeve, institucioneve dhe normave shoqërore. Është e rëndësishme të sigurohet që të dëgjohen zërat e grave për vendimet që prekin jetët e tyre, jetët e familjeve të tyre dhe komunitetit më gjërë. Këto vendime prekin gratë po aq sa edhe burrat. Prandaj, gratë duhet të përfshihen në vendimmarrje në çdo fushë dhe të kenë fuqi dhe numër të barabartë me burrat. Është përgjegjësi e qeverisë të sigurojë që grave iu ofrohen mundësi për të marrë pjesë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes dhe se institucionet përfaqësojnë një llojllojshmëri të njerëzve dhe komuniteteve që ato përfaqësojnë.

Fokusimi ynë do të përfshijë fushën e politikës, sistemin politik e veçanërisht partitë politike dhe funksionimin e tyre në Kosovë. Ideja dhe dëshira erdhi nga arsyeja sepse konstituimi i një sistemi politik demokratik në vendin tonë ka vështirësitë, problemet dhe sfidat që ja vlen të studiohen dhe analizohen nga çdo studiues, e sidomos nga ne të shkencave politike.

Prandaj qëllimi i këtij hulumtimi është që të analizojë nivelet e tanishme të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse në Kosovë. Këto tematika do të jenë pjesë e punimit të diplomës ku synojmë të jemi sa më të mirë duke reflektuar me fakte dhe argumente në studimin që do të bëhet.

Fjalët kyçe: Politikë, Grua, Kosovë, Vendimarrje, Kuota, Pjesëmarrje

Mirënjohje dhe Falenderime

Si në shumicën e herave, Falenderimet dhe mirënjohjet e veçanta u takojnë familjes time, të cilët më qëndruan afër gjatë gjithë jetës, e posaqërisht për mbështetjen dhe përkrahjen gjatë studimeve, qoftë nga aspekti ekonomik por edhe më shumë për mbështetjen morale si familje.

Nuk duhet të harrojmë shoqërinë apo kolegët nga fakulteti me të cilët rrugëtuam gjatë këtij procesi akademik, i cili ishte sa sfidues por edhe na dha kënaqësinë e studimeve dhe krijimin e raporteve të shëndosha kolegjale.

Jam pafundësisht mirënjohëse ndaj profesorëve të cilët dhanë maksimumin gjatë studimeve, duke na dhënë njohuri, këshilla dhe udhëzime me qëllimin që të jemi sa më të suksesshëm në objektivat dhe qëllimet tona.

Për fund, sinqerisht e falenderojë mentorin e temës Prof.dr. Ruzhdi Matoshi, i cili më bëri të kuptojë rëndësinë e një teme/punimi të diplomës për përmbylljen e studimeve Bachelor, dhe që gjatë gjithë procesit ishte i afërt dhe i gatshëm për të më ofruar ndihmë në finalizimin e Temës së Diplomës.

Përmbajtja

1 . Hyrje	6
2. Shqyrtimi i Literaturës	7
2.1 Historiku i lëvizjes së grave dhe lëvizjeve për barazi gjinore	7
2.2 Konteksti historik i Kosovës mbi pozitën e gruas në politikë	8
2.3 Korniza ligjore për promovimin e barazisë gjinore dhe Korniza ligjore në mbrojtje të pjesëmarrjes së grave në politikë	10
2.4 Gruaja në vendimarrje dhe gjendja aktuale e pozitës së grave në Kosovë	11
3. Deklarimi i Problemit.....	13
3.1 Kushtet e pafavorshme socio-kulturore për pjesëmarrje në politikë.....	13
3.2 Pengesat politike dhe ekonomike përballë rrugëtimit dhe zhvillimit të gruas në procese	14
3.3 Kuota Gjinore në legjislacionin e Kosovës.....	16
3.4 Vështirësitë dhe sfidat e gruas në proceset zgjedhore	18
3.5 Rregullimi i statutit të gruas tek partitë politike në Kosovë	20
4. Metodologjia.....	22
4.1 Rëndësia e trashëgimisë politike dhe institucionale mbi progresin politik të grave ...	23
4.2 Roli i grave në pozita vendimarrëse në parti, institucione publike në nivel qendror dhe lokal	25
4.3 Politikanet gra nëpër botë dhe fuqia e tyre.....	26
4.4 Sfidat politike, ligjore, kulturore	28
4.5 Rëndësia e mediave për imazhin dhe faktorizimin e grave në skenën politike kosovare	30
5. Përfundime	33
6. Bibliografia.....	35
6.1 Burime nga Interneti.....	36

1 . Hyrje

Rritja e pjesëmarrjes së grave në jetën publike përbën një element kyç për zhvillim dhe demokratizim të një vendi. Përfshirja e grave në të gjitha aspektet e jetës politike është e rëndësishme jo vetëm sepse gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë, por edhe sepse arritja e pjesëmarrjes së balancuar të grave dhe burrave në vendimarrjen politike dhe publike është çështje e zotërimit të plotë të të drejtave të njeriut, drejtësisë sociale dhe një kusht i nevojshëm për funksionim më të mirë të një shoqërie demokratike. Arritja e pjesëmarrjes së barabartë të grave dhe burrave në vendimarrjen politike dhe publike çon në vendimarrje më të mirë dhe më efektive dhe ripërkufizim të prioritetëve politike dhe vënie të çështjeve të reja në agjendën politike. Gjithashtu, kjo kontribon në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Qasja e barabartë e burrave dhe grave në vendimarrje është parakusht i domosdoshëm për qeverisje demokratike. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e balancuar e të dy gjinive në vendimarrje politike dhe publike është një nga faktorët kyç që mundëson barazinë gjinore, duke avancuar kështu realizimin e të drejtave të njeriut dhe llogaridhënie më të mirë për gratë.

Është dëshmuar se gratë në pozita vendimarrëse përbëjnë faktor të rëndësishëm në krijimin e politikave më të mira që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetën e grave dhe vajzave në veçanti, dhe atë shoqërore në përgjithësi. Dhe angazhimi për përfaqësim më të barabartë në institucione ndikon drejtpërdrejtë në zvogëlimin e padrejtësive dhe kohezionin shoqëror.

Partitë politike kanë rol vendimtar në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe rrjedhimisht edhe promovimin e vlerave demokratike. Përfshirja e grave në politikë e vendimarrje, si dhe vendosja e tyre në pozita udhëheqëse në masë të madhe varet nga partitë politike, si dhe reflekton pozitën e gruas brenda tyre.

Diskutimi me këto grupe synon të shehë pozitën e grave në vendimarrje, të adreson sfidat dhe pengesat me të cilat ballafaqohen deri te arritja e këtyre pozitave, si dhe identifikimin e sfidave me të cilat ballafaqohen në rolin e tyre. Ne gjithashtu kemi diskutuar për politikën që ato ishin në gjendje të iniciojnë ose mbështesin dhe përfitimet dhe vlerave të shtuara të grave në vendimarrje.

2. Shqyrtimi i Literaturës

2.1 Historiku i lëvizjes së grave dhe lëvizjeve për barazi gjinore

Rëndësia e pjesëmarrjes së grave në politikë është e njohur ndërkombëtarisht. Pas shumë vitesh, më 1948, me insistimin e Anna Eleanor Roosevelt që drejtonte Komisionin për të Drejtat e Njeriut në OKB, të drejtat e grave në mënyrë të posaçme u artikuluan në Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut.(epoka e re, 2021, fq.1).

Ndërkaq, Konventa për t'i dhënë Fund Diskriminimit Ndaj Grave (CEDAW) u bën thirrje shteteve nënshkruese që të sigurojnë të drejtën e barabartë të grave për të qenë të pranueshme dhe për të mbajtur poste publike . Në Rezolutën e 2012-ës për Gratë dhe Pjesëmarrjen Politike, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së u bën thirrje të gjitha shteteve që të: “ inkurajojnë fuqishëm partitë politike që të largojnë të gjitha pengesat të cilat drejtpërdrejt apo tërthorazi diskriminojnë pjesëmarrjen e grave, të zhvillojnë kapacitetet e tyre për të analizuar çështjet nga një perspektivë gjinore, dhe të miratojnë politika për të përkrahur aftësitë e grave që të marrin pjesë plotësisht në të gjitha nivelet e vendim-marrjes brenda partive politikeii“. Organizatat ndërkombëtare ua kanë paraqitur partive praktikatat e mira për të mbështetur gratë si anëtare të partive, candidate dhe përfaqësuese të zgjedhura.(NDI, 2015, f.8).

Zhvillimi politik i grave kosovare është ballafaquar me pengesa të panumërta. Në dekadat pas Luftës së Dytë Botërore problemet kryesore kanë qenë analfabetizmi dhe mentaliteti patriarkal, kurse gjatë viteve '90, për shkak të çrregullimeve sistemore në mënyrën e funksionimit të jetës në Kosovë, të imponuara nga regjimi serb, gratë kanë pasur hapësirë shumë të reduktuar për aktivitet politik. Për këtë arsye, nevojitet një vazhdimësi e masave të fuqishme institucionale në mënyrë që të korrigjohen zbrazësitë e krijuara nga e kaluara. (QKSG, 2009, f.19).

Normat ligjore dhe kushtetuese, konventat ndërkombëtare, që mbështesin të drejtat civile në baza gjinore, mobilizimi qytetar, veprimet avokuese, monitorimi, ngritja e kapaciteteve, vizitat studimore dhe veprime tjera të strukturuar në strategji specifike, që do ndërmarrë FGPV, janë masa të mbështetura në integrim gjinor e parime demokratike, për të garantuar progres në përmbushjen e të drejtave të barabarta për të gjithë

Të gjitha këto kanë rëndësi pasi pjesëmarrja në politikë përfshin aktivitete të shumëllojta si votimi në zgjedhje, angazhimi në fushata zgjedhore, anëtarësia aktive në parti politike dhe shoqata lobuese, kontaktimi i politikanëve, dalja në protesta dhe tubime tjera publike, nënshkrimi i peticioneve, bojkotimi i produkteve të caktuara etj. Përveç ndikimit të mundshëm në trajektoret dhe rezultatet e politikave publike, pjesëmarrja e grave në politikë konsiderohet e mirë në vetvete në sistemet demokratike. Ajo përhap konsultimin qytetar, vetëdijen për tema publike, legjitimitetin e politikave, shanset për jetë dhe përmbushje.(sbunker, 2018, f.1).

Fatkeqësisht roli dhe pozita e grave në politikë shihet me skepticizëm, sepse e vërteta qëndron se partitë politike nuk janë krijuar mbi interesat e strukturave të ndryshme të shoqërisë e as mbi koncepte programore e politike të dallueshme. Ato në të shumtën e rasteve, janë ndërtuar ose mbi një ideologji populiste ose mbi interesa të grupacioneve të vogla politike (Kosumi, 2001, f.72).

2.2 Konteksti historik i Kosovës mbi pozitën e gruas në politikë

Viti 1999 ka shënuar ndryshim rrënjësor në mënyrën e funksionimit të shoqërisë kosovare. Transformimi i plotë i sistemit politik, ekonomik dhe atij kulturor ka bërë që fushat e caktuara të veprimtarisë shoqërore, si studimet gjinore të ristrukturohen si në aspektin kualitativ, ashtu edhe në atë kuantitativ(QKSG, 2009, f.5).

Pas përfundimit të luftës, me këmbënguljen e politikës amerikane, ndryshimi i statusit të Kosovës u ideua të zgjidhet përmes një përfaqësuesi special të OKB-së, në këtë rast Marti Ahtisarit, i cili do të hartonte një plan gjithëpërfshirës, ku do të përfshiheshin të gjitha etnitë në Kosovë, por që kishte një element thelbësor të zgjidhjes dhe ai element thelbësor ishte shpallja e pavarësisë, që nënkuptonte qëllimin kryesor të të gjitha gjeneratave në Kosovë, pra, ditën e pavarësisë dhe shpalljes së Republikës së Kosovës. Kështu, përfundimisht më 17 Shkurtin 2008, Kuvendi i Kosovës miratoi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës (Bajrami, 2010, f.387).

E vërteta qëndron se as përmbysjet e sistemeve dhe as rotacioni i vazhdueshëm në politikën e vendit nuk kanë ndikuar në përmirësimin e situatës së përfaqësimit të grave në politikë.Kosova ka arritur që legjislacionin e saj ta ndërtojë bazuar në standardet e barazisë dhe diversitetit, si vlera për të respektuar dhe promovuar të drejtat dhe liritë e njeriut. Megjithatë,

përqindja e ulët e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje nuk përkon me përqindjen e grave në shoqëri. Nga nivel i lokal deri në nivel kombëtar, gratë janë të nën përfaqësuara në shumicën e posteve udhëheqëse, qofshin ato poste të zgjedhura, të shërbimit civil, apo dhe të sektorit privat. Pavarësisht të drejtave të grave për të marrë pjesë në mënyrë të barabartë në qeverisjen demokratike apo dhe aftësitë e vullnetin e tyre për t'u dëshmuar si udhëheqëse të suksesshme, praktikat në shoqërinë tonë, kanë tendencë t'i japin gruas më pak zë politik dhe fuqi të kufizuar vendimmarrëse.(kdi-kosova, 2021, f.1).

Kjo gjendje ka ardhur për shkak të shumë rrethanave e një pjesë e sqaron Profesori Universitar Adem Behan në librin e tij ku shprehet që“në një ambient politik ku partitë e trajtonin njëra-tjetrën si armike“, problemi i demokratizimit brendapartiak nuk ishte fare temë prioritare. Demokratizimi i brendshëm partiak, autonomia e degëve dhe e nëndegëve, pluraliteti i mendimeve dhe i qasjeve kundrejt politikës partiake, përzgjedhja meritokratike e kandidatëve të partive politike, nuk ishin pjesë e agjendës politike të partive politike”(Beha, 2017, f.10).

Kronologjikisht në Kosovë u mbajtën në zgjedhjet e dyta komunale në vitin 2004, dhe u aplikua kuota prej 30 për qind, gjë që rezultoi me ndryshimin e raportit gjinor edhe në nivelin lokal. Sa i përket nivelit qendror, në zgjedhjet e para të përgjithshme, që u mbajtën në vitin 2001, Komisioni Qendror Zgjedhor vendosi që çdo i treti kandidat në listat zgjedhore të partive politike në Kosovë të jetë grua. Ky vendim vlente edhe për përfaqësimin e grave me 30 për qind në Kuvendin e Kosovës. (QKSG, 2009, f.19-20).

Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm në rritjen e numrit të grave në udhëheqjen politik. Edhe pse numri i grave në pozicione drejtuese ekzekutive mbetet i ulët, prania e grave me ndikim në një pjesë të vogël të pozitave kyçe është duke e ndryshuar qëndrimin publik në lidhje me gratë dhe është duke e krijuar momentin për rritjen e lidhjes së grave në të ardhmen. Zbatimi i legjislacionit për kuotën gjinore, ka hapur rrugë më të gjëra për pjesëmarrjen e grave në politikë si dhe i ndihmon gratë në tejkalimin e pengesave për pjesëmarrje në politikë. Duke rritur numrin e grave që shërbejnë si model në poste publike, gjithashtu ndihmon në ndryshimin e opinionit publik në lidhje me aftësitë e grave për të marrë pjesë në politikë.(NDI, 2015, f.8).

2.3 Korniza ligjore për promovimin e barazisë gjinore dhe Korniza ligjore në mbrojtje të pjesëmarrjes së grave në politikë

Megjithëse Kosova nuk është nënshkruese e marrëveshjeve madhore ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Kushtetuta e Kosovës thekson se të gjitha instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë të zbatueshme drejtpërdrejt. Më saktësisht, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW) mishërohet gjithashtu në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës. Promovimi dhe fuqizimi i lirive dhe të drejtave të njeriut si dhe trajtimi i barabartë i të gjithë qytetarëve të Kosovës rregullohet përmes legjislacionit të ndryshëm civil dhe penal përfshirë pakon e legjislacionit për të drejtat e njeriut (d.m.th. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, ligji për Avokatin e popullit dhe Ligji për barazi gjinore), që hyri në fuqi në korrik të vitit 2015. Miratimi i pakos së legjislacionit për të drejtat e njeriut u theksua si një hap i madh para në Raportin e Komisionit Evropian të vitit 2015 për Kosovën. Ai fuqizoi strukturën institucionale dhe sqaroi rolet e institucioneve të ndryshme (QKSG, 2017, f.13).

Ligji zgjedhor i Kosovës rregullon zbatimin e kuotës gjinore prej 30 për qind ulëse në kuvendet komunale dhe atë kombëtar. Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për herë të parë aplikoi sistemin e kuotave gjinore në Kosovë në tetor të vitit 2000. Rregullorja 39/2000, paraqitur nga UNMIK-u, kërkonte së paku 30 për qind të kandidatëve femra në listat e partive e që gjeti mbështetje të fuqishme nga gratë kosovare dhe shoqëria civile. Sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ-ja duhet të sigurojë që listat e partive të aplikojnë kuotën gjinore në mënyrë që të certifikohen. KQZ-ja duhet gjithashtu të zbatojë kuotën gjinore edhe në shpërndarjen vendeve në Kuvend mes partive politike. Përderisa disa e kontestojnë vlerën e kuotës gjinore, shumica e shohin pozitivisht futjen e saj në Kosovë, pasi që kjo ka çuar direkt në rritjen e numrit të grave në Asamblenë Kombëtare, Parlamentin e Kosovës. (NDI, 2015, f.9).

Gjithashtu Pakoja e Ligjeve Kundër Diskriminimit që ka është adoptuar në vitin 2015, ku bëjnë pjesë: Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për Ombudspersonin dhe Ligji për Barazi Gjinore, garantojnë të drejta të barabarta të pjesëmarrjes së jetës publike të qytetarëve (sbunker, 2019, f.1)

Edhe pse partitë politike mund të pretendojnë të kenë interes në avancimin e grave, kjo retorikë nuk përkthehet domosdoshmërisht në përkushtim real kështu që partitë përballen me sfida të shumta gjatë realizimit. Megjithatë, pjesëmarrja e lartë e votuesve femra në zgjedhjet komunale të 2013-ës ka rritur ndërgjegjësimin e udhëheqësve partiak për fuqinë e votave të

grave, e kjo krijoi një mundësi për ndryshim. Është një vlerësim në rritje për fuqinë politike të grave dhe përparësitë që kandidatet gra u sjellin partive duke tërhequr votat e grave, nëse jo domosdoshmërisht vlera e grave si anëtare të partive, apo udhëheqëse dhe zyrtare të qeverisë.

Ky raport përshkruan disa nga çështjet e ngritura në takimet e ekipit të vlerësimit dhe ofron një kornizë për tejkalimin e pengesave për rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë në Kosovë.

2.4 Gruaja në vendimarrje dhe gjendja aktuale e pozitës së grave në Kosovë

Në teori, ky ligj poashtu obligon të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore, si dhe institucionet e tjera publike të sigurojnë përfaqësim të barabartë gjinor prej 50 përqind për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse. Ligji poashtu parasheh sanksione për dështim të zbatimit të dispozitave të tij. Por, si me shumë ligje të tjera në Kosovë, në praktikë ndodh krejt ndryshe. Përfshirja e grave në vendimarrje dhe udhëheqje, qoftë brenda sektorit publik apo privat, vazhdon të mbetet sfida e madh, dhe pabarazia gjinore pengon gratë që të kontribuojnë dhe të ndikojnë në agjendat e zhvillimit (kosovo two point zero, 2019).

Edhe pse femrat përbëjnë gati gjysmën e popullatës së Kosovës, është e paimagjinueshme pjesëmarrja e tyre e ulët në politikë dhe në jetën publike. Normalisht, në një vend ku gati 50% e popullsisë përbëhet nga gjinia femërore, pjesëmarrja në pozicionet vendimmarrëse të gjinive do të duhej të ishte në të njëjtat kuota (Zogiani, 2013, f.3).

Në ditën globale të OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë, Udhëheqësja e UN Women në Kosovë, znj. Flora Macula, foli për marrëdhënien esenciale mes pjesëmarrjes së gruas në politikë dhe shoqërisë më të drejtë. Ajo nënvizoi se paqja dhe zhvillimi i qëndrueshëm nuk janë të mundshme pa pjesëmarrjen e barabartë dhe përfshirjen e plotë të grave në të gjitha fazat e zhvillimit. Znj. Macula po ashtu theksoi nevojën e demokratizimit të partive politike si një faktor kyç i përfshirjes së grave në vendimarrje. Ajo gjithashtu vuri në pah rëndësinë e rritjes së angazhimit me meshkuj dhe djem, dhe ftoi gratë që tanimë kanë pozita në pushtet që të krijojnë kushte për fuqizimin e grave dhe vajzave të tjera (UNMIK, 2018, f.5).

Në Republikën e Kosovës janë nxjerrë një varg ligjesh dhe politika të cilat kanë për qëllim arritjen e barazisë së femrave dhe meshkujve në shoqëri dhe mënjanimin e pabarazisë gjinore ekzistuese në nivele udhëheqëse.

Shprehimisht, neni 7, paragrafi 2 i Kushtetutës së Kosovës përcakton se: Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabartë për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe fushat e tjera shoqërore. Për më tepër, neni 71, paragrafi 2 i po kësaj kushtetute thekson se Përbërja e Kuvendit të Kosovës do të respektoj parimet e barazisë gjinore të cilat janë të pranuar në pajtim me parimet ndërkombëtare. Pastaj, neni 3, paragrafi 1 ligjit nr.2004/2 mbi barazinë ligjore i miratuar në vitin 2009, përcakton pjesëmarrje të barabartë të femrave dhe meshkujve në organet e të gjitha niveleve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike. (Kushtetuta e Kosovës, 2008, f.4). Por megjithatë, me gjithë ekzistimin e bazës ligjore, kuotave gjinore të cilat garantojnë pjesëmarrjen e femrave kosovare në të gjitha proceset vendimmarrëse, kyçja e tyre reale në procese të rëndësishme vendimmarrëse është ende shumë e kufizuar. Femrat janë të tejkaluara nga meshkujt thuajse në të gjitha fushat me përgjegjësi.

Nga studimet të ndryshme, të dhënat tregojnë se sfida kryesore që përcjell gratë në pozita vendimmarrëse në punën e tyre është mbështetja e pamjaftueshme që ato marrin nga të tjerët (53% e të anketuarave) dhe mungesa e besimit tek të tjerët ndaj grave (31%). Gjatë intervistave gjysmë të strukturuar është theksuar se duke qenë se shumica e pozitave vendimmarrëse janë të mbuluara me burra atëherë edhe mbështetja që gratë vendimmarrëse është më e kufizuar. Në një intervistë u theksua se ‘sikur rreth tavolinës të ishim më shumë gra vendimmarrëse atëherë ne do kishim fuqi vendimmarrëse për të përmirësuar pozitën e gruas në institucione (Zyra e Kryeministrit, 2014, f.35).

Me gjithë përpjekjet për fuqizimin e femrës në vendimmarrje, kjo ende mbetet ndër sfidat kryesore me të cilat ballafaqohet shoqëria kosovare. Femrave në politikën kosovare ende nuk iu besohen poste të larta udhëheqëse, dhe fajtor kryesor për këtë janë vetë partitë politike të cilat të shtyra nga mendimi regresiv se zgjedhjet fitohen bindshëm vetëm nga meshkujt, i marginalizojnë anëtarët e tyre të partisë duke i'u zbehur kështu mundësinë për të shtyrë procese të rëndësishme përpara dhe për të marrë vendime të rëndësishme (Zogiani, 2013, f.3).

3. Deklarimi i Problemit

3.1 Kushtet e pafavorshme socio-kulturore për pjesëmarrje në politikë

Barazia gjinore në sferën publike mbetet sfidë për shumë vende anembanë botës. Kjo ndodh sepse gratë mbesin prapa burrave sidomos në mbajtjen e pozitave udhëheqëse në sektorin publik dhe atë privat. Niveli i sfidës varion nga shteti në shtet dhe për ne si një shoqëri që po kalon tranzicionin, këto sfida janë më kritike për shoqërinë kosovare.

Kultura patriarkale vazhdon të dominojë politikën dhe qeverisjen. Burrat kanë autoritet mbi gratë në të gjitha aspektet e shoqërisë në Kosovë, duke përfshirë politikën dhe qeverinë. - Gratë në pozitat vendimmarrëse shpesh stigmatizohen nga shoqëria për shkak të gjinisë së tyre. Gratë shpesh shihen si të papërshtatshme për të mbajtur një rol udhëheqës dhe kur ata marrin këto role, përkundër burrave, veprimet e tyre shqyrtohen shumë më shumë nga publiku. Burrat shihen si një gjini e duhur/e favorshme për të udhëhequr pozitat vendimmarrëse, ndërsa gratë konsiderohen si më pak të afta për këto vende pune (INDEP, 2019, f.16).

Në Kosovë politika vazhdon të konsiderohet fushë e dedikuar për burrat. Paragjykimet gjinore, besimi i përgjithshëm se burrat janë udhëheqës më të mirë dhe mungesa e përkrahjes politike, janë disa nga shkaqet që pamundësojnë ose pengojnë shumë promovimin e grave në pozita vendimmarrëse. Po ashtu, puna e papaguar, mirëmbajtja e shtëpisë dhe kujdesi për familjarët dhe mungesa e qendrave të kujdesit ditor për fëmijët, i vendosin gratë dhe burrat në raport shumë të pabarabartë lidhur me kohën e disponueshme për t'iu dedikuar angazhimit politik e publik. Kështu, gratë nuk arrijnë të angazhohen sa duhet në aktivitete të rrjetëzimit politik dhe ngritje të fondeve, çfarë iu kufizon qasjen në burime për financimin e fushatave të tyre politike (kosovo two point zero, 2019).

Udhëheqësit e partive njëzëri pajtohen që partitë luftojnë për të mbajtur anëtarët gra të angazhuara në mes të cikleve zgjedhore. Mungesa e trajnimit dhe mundësive për të udhëhequr i dekurajon gratë nga përfshirja e mëtutjeshme në politikë. Thjesht vendosja e grave në listat e kandidatëve nuk është e mjaftueshme. Për më tepër, partitë nuk kanë një strategji për mbajtjen e kandidateve femra që nuk fitojnë zgjedhjet dhe për përgatitjen e tyre për ciklin e ardhshëm zgjedhor.

Kandidatet gra përballen me konkurrencë të brendshme më të madhe për shkak të gjinisë së tyre dhe mungesës së një përvoje në udhëheqje. Përderisa sistemi i votimit preferencial u lejon grave kandidate të ndërtojnë një bazë popullore të mbështetjes së tyre, kjo i detyron ato që të konkurrojnë kundër kolegëve anëtarë të partisë. Pavarësisht mbështetjes së fuqishme lokale dhe kredencialeve të mira, shumë femra më tutje duhet të konkurrojnë me kandidat të njohur meshkuj për pesë pozitat në dispozicion në fletën e votimit preferencial. Partitë i dëmtojnë gratë kandidate duke promovuar kandidatët e favorizuar, shumica prej tyre meshkuj, dhe dekurajojnë alokimin e resurseve për gratë mbi bazën se kuota do tu sigurojë pozitat. Në një rast, NDI mësoi se një parti mbante dy lista, një për gratë dhe një për burrat, për të promovuar kandidatët meshkuj. Shumë gra kanë raportuar se ky konkurrim i brendshëm i dekurajon ato që të kërkojnë post politik(NDI, 2015, f.17).

Në një raport thuhet se pengesat kryesore strukturore në pjesëmarrjen e grave në politikë janë si në vijim: 1) ekzistimi i vlerave thellësisht të rrënjosura patriarkale dhe i stereotipeve gjinore për rolin dhe pozitën e gruas në shoqëri; 2) mungesa e vullnetit politik brenda partive politike për promovimin e kandidateve femra, posaçërisht në rolet udhëheqëse; 3) mungesa e qasjes së grave në resurse dhe media gjatë fushatave të tyre dhe 4) prania e diskriminimit gjinor dhe stereotipeve në media(UNMIK, 2018, f.9).

3.2 Pengesat politike dhe ekonomike përballë rrugëtimit dhe zhvillimit të gruas në procese

Pas rënies së komunizmit në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore dhe transicionit për në demokraci dhe ekonomi të tregut, u krijua një kosto e lartë e burimeve njerëzore në përgjithësi. Kjo kosto, përpos papunësisë së madhe, u shoqërua me rënien e natalitetit, rritjen e prostitucionit, rënien e interesimit për martesë, rritjen e emigracionit dhe trafikimit të qënieve njerëzore. (Mulaj, 2009, f. 221-255). Grupi më i goditur padyshim se ishin gratë.

Realisht, gratë nuk kanë mundësi të qasjes në rrjete të cilat burrat në mënyrë rutinore i përdorin për të ngritur profilet e tyre. Kandidatet gra i vunë në dije ekipit vlerësues se kanë pak mundësi qasjeje në rrjete, veçanërisht në zonat rurale, gjë që e bën më të vështirë për gratë të lidhen me votuesit dhe të kërkojë mbështetjen e tyre. Mjediset në të cilat diskursi politik lokal

është tradicional, si odat në familjet tradicionale shqiptare, janë në mënyrë tipike të zotuar nga burrat dhe janë pak të arritshme për gratë. Vendimet se cilët kandidat do të mbështesin partitë shpesh janë bërë në mjedise të tilla, përsëri duke i dëmtuar gratë kandidate, duke ua pamundësuar pjesëmarrjen(NDI, 2015, f.16).

Partitë politike të intervistuar nga ekipi i vlerësimit zakonisht raportojnë se kandidatet gra nuk i kanë burimet e nevojshme për të filluar një fushatë të fortë parazgjedhore. Shumica e partive deklarojnë se ata nuk ishin në gjendje të ofrojnë mbështetje financiare apo trajnime për kandidatet para zgjedhjeve. Një parti ofroi një nivel modest të mbështetjes për të gjithë kandidatët duke u ofruar atyre fletëpalosje, materiale dhe mbështetje në komunikim. Një tjetër parti i tha ekipit të vlerësimit se me kandidatët kanë qenë të sigurtë dhe ju kanë treguar se duhet të jenë të vetë mbështetur dhe të financuar në mënyrë të pavarur. Kjo politikë ndikon si në kandidatët meshkuj ashtu edhe femra, por gratë mund të kenë më pak mundësi apo gatishmëri për të shpenzuar financat personale në një fushatë politike. Sa për krahasim, kandidatët meshkuj shpesh kanë qasje më të madhe në burimet partiake si dhe në mundësitë për mbledhjen e fondeve nëpërmjet rrjeteve të ndryshme të biznesit të cilave ata edhe u përkasin. Në raste të tjera, kandidatët që kanë lidhje familjare me udhëheqjen e një partie apo themeluesit e saj kanë avantazhe të dallueshme për të fituar zgjedhjet, e kjo marginalizon më tej grupet e tilla si gratë(NDI, 2015, f.16).

Kjo është për keqëardhje sepse Buxhetet publike përfaqësojnë angazhimet e qeverisë dhe përcaktojnë prioritetet sociale dhe ekonomike. Gjatë planifikimit buxhetor, qeveritë duhet të sigurohen që burimet e tyre të ndikojnë në mënyrë të barabartë në të gjitha grupet e shoqërisë. Pjesëmarrësit e fokus grupeve deklaruan se kjo praktikë mungon në institucionet e Kosovës, ku buxhetet janë planifikuar pa marrë parasysh aspekte të ndjeshme gjinore(INDEP, 2019, f.15).

Pavarësisht kësaj, barazia gjinore në Kosovë, veçanërisht në pozitat vendimmarrëse mbetet sfidë. Gratë shënojnë grupin më të papunësuar në shoqëri, me vetëm 12.7 përqind të grave të punësuar, krahasuar me 46.6 përqind të burrave, duke arritur humbjet e mundshme ekonomike prej rreth 28 përqind të të ardhurave qendrore bruto - më të lartat midis vendeve të Ballkanit Perëndimor¹. Kjo tregon se gratë në Kosovë janë të papunësuar dhe si rezultat, humbjet në të ardhurat bruto janë më të lartat në rajon(INDEP, 2019, f.4).

Përkundër se kushtet në tregun e punës janë më të pafavorshme për gruan, edhe politika e transfereve sociale favorizon më tepër burrat. Sipas të dhënave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), përveç që përgjatë viteve ka pasur më shumë përfitues burra të pagesave me para në dorë, gratë më së shumti marrin pjesë në skemat që japin pagesat më të vogla: pensionet bazë të moshës dhe ndihmën sociale të varfërisë. Kështu, politika sociale e Kosovës dëshmon se nuk është e interesuar për të balancuar kushtet ndërmjet gjinive në punë ose për t'i korrigjuar ato dhe kushtet e trashëguara përgjatë dekadave - përmes redistribuimit, pra transfereve dhe taksave (sbunker, 2018, f.4).

Mediat janë kanali më i rëndësishëm i komunikimit në mes politikës dhe qytetarëve. Për këtë arsye, shkalla e qasjes në media ndikon drejtpërdrejt edhe në nivelin e suksesit politik. Mungesa e grave në pozita të rëndësishme institucionale dhe në hierarki të partive kryesore në Kosovë, por edhe të qenit udhëheqëse/anëtare të partive të vogla ka bërë që gratë politike të mos kenë prezencë të duhur në media (QKSG, 2009, f.43).

3.3 Kuota Gjinore në legjislacionin e Kosovës

Ndërsa kërkesat teknike të kuotës zgjedhore të Kosovës kanë qenë të vëzhguara në përgjithësi, fryma e ligjit nuk është vëzhguar. Gratë nuk janë kultivuar si kandidatë ose udhëheqëse, as nuk u është dhënë mbështetje sikurse kandidatëve meshkuj. Në disa raste, kandidatët meshkuj përdorin kuotën për të argumentuar se gratë nuk kanë nevojë për të marrë mbështetjen e partisë gjatë fushatës për shkak se ato kanë vende të garantuara.

Rekrutimi jo formal dhe procesi i emërimit i la gratë të pafavorizuara për shkak të rrjeteve të dominuara nga meshkujt dhe afatit të shkurtë për rekrutim. Femrat shpesh janë rekrutuar në minutën e fundit për të plotësuar numrin minimal të pozitave të kërkuara ligjërisht.

Që nga viti 2007, Kosova ka pasur sistemin e listave të hapura të partive, në të cilat votuesit mund të votonin për një parti si dhe të zgjidhnin nga kandidatët e renditur me emra në listat e partive. Në zgjedhjet parlamentare, votuesit mund të votonin deri në pesë kandidatë sipas preferencave votuese, dhe mund të votonin për një kandidat në zgjedhjet komunale. Me kalimin e kohës, u rrit numri i grave që u zgjedhën përmes votimit preferencial, duke sinjalizuar mbështetje më të madhe publike për gratë candidate (NDI, 2015, f.10).

Me të vërtetë kuota gjinore u ka ndihmuar shumë grave që të jenë pjesë e parlamentit, por për herë të parë në zgjedhjet e 6 tetorit, vetëm 13 nga 39 gratë e zgjedhura kishin nevojë për kuotën gjinore që të bëhen deputete. Kurse, 26 gra nga të gjitha partitë politike në legjislaturën e shtatë të Kuvendit të Kosovës nuk kishin nevojë për kuotë për t'u bërë pjesë e Parlamentit.(evropa e lirë, 2021, fq.3).

Pavarësisht efikasitetit në ngritjen e qasjes së grave në politikë, kuota mund të përdoret kundër grave. Anëtarët meshkuj të partive që garojnë kundër grave në votim preferencial u thonë përkrahësve se gratë kandidatë do t'i fitojnë postet automatikisht përmes kërkesës së kuotës, kështu që nuk ka nevojë të “hidhen votat kot” duke dhënë votat preferenciale për kandidatet gra. Kjo parandalon më shumë gra për t'u zgjedhur dhe mund të shtrembërojë procesin zgjedhor me nën-përfaqësimin e kandidateve gra krahasuar me mbështetjen që janë në gjendje ta mbledhin(NDI, 2015, f.11).

Në një panelë të mbajtur në vitin 2018 Panelistët u pajtuan se ka nevojë që: 1) të bëhet reforma zgjedhore, të rishikohen të gjitha ligjet dhe të bëhen ndryshimet e nevojshme për të plotësuar standardet e caktuara sipas Ligjit për barazi gjinore; 2) të rritet llogaridhënia e autoriteteve për moszbatimin e Ligjit për barazi gjinore; 3) të sigurohet demokratizimi i partive politike përmes emërimit të grave në pozita udhëheqëse dhe ofrimit të përkrahjes më të madhe për to gjatë fushatave; 4) të inkurajohen partitë politike për t'iu paraprirë gjërave dhe për të punuar me femra dhe meshkuj të ri në mënyrë që ata të mund t'i zhvillojnë përvojat e tyre politike, të kenë ekspozim më të gjatë dhe të përgatiten për hyrje në politikë dhe 5) të vazhdohet me aplikimin e kuotave në Kosovë, por të sigurohet njëkohësisht trajtimi i çështjeve më të gjëra shoqërore dhe kulturore me qëllim të heqjes së pengesave strukturore për pjesëmarrjen e grave në politikë(UNIMIK, 2018, f.11).

Edhe gratë politikane më tepër veçojnë ato që fitojnë postin në bazë të votave se sa ato si rezultat i kuotës. Shpesh, gratë deputete e identifikojnë veten me numrin e votave që kanë marrë në zgjedhjet e fundit. Për t'iu shmangur marginalizimit, gratë që janë zgjedhur si rezultat i kuotës duhet dalluar veten e tyre dhe duhet që në fillim të punojnë që të dëshmojnë se kontributi i tyre bën dallim dhe se ato janë serioze në rolet e tyre si parlamentare dhe vendimmarrëse. Është e rëndësishme që strukturat e grave brenda partive, gratë deputete dhe partitë politike të ndalen

së bëri dallime midis grave të zgjedhura përmes mekanizmave të ndryshëm, pasi që gratë deputete duhet të trajtohen me respekt të barabartë(NDI, 2015, f.12).

3.4 Vështirësitë dhe sfidat e gruas në proceset zgjedhore

Para mbajtjes së zgjedhjeve të përgjithshme, “ UNMIK-u, përkatësisht OSBE-ja si njëra prej shtyllave kryesore të tij, dizajnoi sistemin zgjedhor në Kosovë. Korniza Kushtetuese tashmë përcaktonte se 20 prej 120 vendeve në Kuvendin e Kosovës do t’u takonin komuniteteve. Duke qenë Kosova shoqëri postkonfliktuale dhe e ndarë në baza etnike, sistemi zgjedhor synonte të ndërtonte – nëse shprehemi me terminologjinë e Arendt Lijphart – një demokraci multietnik , në të cilën pushteti ekzekutiv do të bashkushtrohej nga përfaqësuesit e grupeve të ndryshme etnike”(Arend, 1985, f.864).

Në vendin tonë vërehet mungesa e gatishmërisë së partive për të krijuar hapësirë më të madhe për gratë si kandidatë në listat e partive është pengesa më e vështirë për gratë që duan të kandidojnë për pozita. Madje Zgjedhjet në Kosovë më shumë janë parë si proces i punësimit sesa si një proces i cili mirret drejtpërsëdrejti me raportin qytetar-parti-shtet (Haziri, 2017, f.22).

Qasjet e partive për futjen e grave në listat e kandidatëve ndryshojnë por ka pak shembuj ku partitë shkojnë përtej kërkesave ligjore të kuotës gjinore.Në një panelë të organizuar nga UN Women në vitin 2018, ku paneliste dhe organizatore ishin grate për nderë të Ditës globale e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë, ku të gjithë panelistët ishin pajtuar se gratë që vendosin t’i hyjnë udhës së politikës ballafaqohen me pritje më të larta dhe me standarde të dyfishta, duke filluar nga tejkalimi i presioneve në familje, i vlerave patriarkale dhe i sfidës së përditshme të dëshmimit para zgjedhësve. Ato po ashtu u dakorduan se meritojnë të jenë aty dhe se nuk kanë ardhur vetëm për shkak të kuotës, por falë profesionalizimit, vizionit dhe kapacitetit të tyre. Panelistet theksuan nevojën e fuqizimit të bashkëpunimit ndërsektoral me shoqatat e grave afariste, shoqërinë civile dhe me strukturat vendimmarrëse në nivel qendror e lokal me qëllim të krijimit të mekanizmave mbështetës për fuqizimin e grave dhe vajzave(UNMIK, 2018, f.7).

Në vendin tone, ata që janë në detyrë dhe garojnë prapë, veçanërisht në pozita udhëheqëse, kryesisht janë meshkujt. Të njëjtit kanë marrë shumicën e burimeve financiare, mbështetjen politike dhe paraqitjen gjatë fushatës. Si rezultat, shumica e grave, shumë nga ato që

po bënin fushatë për herë të parë nuk ishin në gjendje të bëjnë fushatë efektive ose të zhvillojnë profilin e tyre publik për ta bërë emrin të njohur.

Kur propozohen kandidatët, në degët e partive rrallë herë emërojnë gra. Liderët e degëve zakonisht janë ndër të parët që propozohen, dhe krejt pak janë femra. Degëve të partive u mungon strategjia për rekrutim dhe mbajtje të grave anëtare mes ciklit zgjedhor, dhe kanë një rreth të vogël të kandidatëve potencial për të zgjedhur. Si rezultat, selitë e partive shpesh duhet të fusin kandidatët e tyre femra për të plotësuar kuotën duke anashkaluar të nominuarit e degës.

Ka mundësi të kufizuara për gratë kandidate për tu futur në listën e partisë së tyre. Emrat e kandidateve femra vijnë nga krahu i dedikuar i grave brenda partive apo nga udhëheqës të partisë, të cilët u lënë grave që aspirojnë për kandidate disa mundësi përmes të cilave ato mund të llobojnë në favor të kandidaturave të veta. Pasi që degët e partive rrallë emërojnë gratë, mundësia e gruas për t'u futur në listën e partisë shpesh varet nga mbështetja e udhëheqësve të lartë të partisë, si dhe nga vlera e profilit të tyre publik, financave dhe aftësive për lidhshmëri partiak. Shumica liderëve të partive me të cilët u takua ekipi i vlerësimit kanë konfirmuar se partitë e tyre e shqyrtojnë përgatitjen paraprake të grave kandidate në mënyrë të detajuar. Situata është ndryshe me kandidatët meshkuj, të cilët gëzojnë një fushë të gjerë të mundësive përmes të cilave ata mund të fitojnë një vend në listën e partisë, duke filluar nga degët e partive, e deri te presidenca e partisë dhe te grupet e interesit brenda dhe jashtë partisë(NDI, 2015, f.12).

Shumë gra nuk shohin ndonjë përparim po të hynin në politikë dhe po t'i hynin një karriere politike e që e bën rekrutimin e grave kandidate për poste më të vështirë. Një anketë e UNDP më 2014 tregon se vetëm tetë për qind të grave janë përfshirë në parti politike, kundrejt 22 për qind të meshkujve. Disa gra të intervistuar përmendin sfidën e suksesit brenda partive politike që dominohen nga meshkujt, ndikimin që hyrja në politikë do të kishte në familjet e tyre, mirëqenien apo karrierën, frikën nga vëmendja e tepruar e mediave, dhe mungesën e besimit në aftësinë e tyre për të shërbyer në mënyrë efektive, si arsye të ngurrimit për të kandiduar për poste. Të dhënat e votimit tregojnë se gati një e treta e grave në popullatën e përgjithshme besojnë se gratë zbrapsen nga burrat në partitë politike, dhe se diskriminimi është një shkak i madh i përfaqësimit të ulët të grave në pozita. Gratë e perceptojnë arenën politike si të njëanshme ndaj tyre(NDI, 2015, f.12-13).

3.5 Rregullimi i statutit të gruas tek partitë politike në Kosovë

Funksioni i parë i partive politike është hartimi i programeve dhe vizioneve të tyre politike. Bazuar edhe në ideologjinë që një parti politike mund ta ndjekë, këto duhet të jenë domosdoshmërisht të ndryshme apo më kreative në kuptimin e programeve politike dhe kandidatëve në mënyrë që të jenë më atraktive për votuesit. Funksioni i dytë është marrja në konsideratë e kërkesave politike, ekonomike dhe sociale të shoqërisë. Në këtë rast, kërkesat mund të jenë nga më të ndryshmet dhe nganjëherë mund të jenë në konflikt me njëra-tjetrën. Për këtë arsye, roli i partive politike është që t'i diskutojnë dhe vlerësojnë çështjet me rëndësi për shoqërinë apo një grup shoqëror dhe t'i shndërrojnë nevojat dhe kërkesat e publikut në politika alternative. Funksioni i tretë: partitë politike janë motori kryesor i rekrutimit të individëve në postet publike, përkatësisht në nivelin ekzekutiv dhe atë legjislativ (Krasniqi dhe Shala, 2012, f.8).

Në këtë pjesë, mund të theksojmë që e kemi Ligjin për barazi gjinore, i cili ligj është të: mbroj, trajtoj dhe vendos, barazi ndërmjet gjinive si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë së Kosovës, me mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve dhe për kontributin e tyre në zhvillimin politik, ekonomik, social, kulturor dhe në të gjitha fushat e jetës shoqërore (Zyra e Kryeministrit-Raport, 2014, f.15)

Në vendin tone praktika ka treguar se se kemi mungesa të zbatimit të Ligjit për Barazi Gjinore nga institucionet publike - kuota 50% për përfaqësimin e barazisë gjinore. Realisht Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, që përcakton se 30% e kandidatëve në listën e partive politike duhet të jenë gra, nuk përputhet me Ligjin për Barazi Gjinore(INDEP, 2019, f.15).

Partitë politike janë larg vullnetit me krijë hapësirë dhe vend për gra, edhe kur ato janë në parti ato nuk posedojnë fuqi reale vendimmarrëse brenda partisë.(Zyra e Kryeministrit-Raport, 2014, f.27).Statuti i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) nuk parasheh kuota gjinore në organet drejtuese të këtij subjekti. Statusi i saj përcakton që kryetarja e Forumit të Gruas së LDK-së është automatikisht edhe anëtare e Këshillit të Përgjithshëm dhe e kryesisë së saj. Mirëpo të gjitha, 38 degët të LDK-së drejtohen nga burrat, kurse vetëm 4 prej 23 anëtarëve të kryesisë së partisë janë gra.

Njësoj, statuti i PDK-së, nuk parasheh kuota të përfaqësimit gjinor në organet e saj. Nga 50 anëtarët e kryesisë vetëm 13 janë gra. Gjendja është e njëjtë edhe në Këshillin Drejtues të saj, ku gratë mbajnë vetëm 38 vende nga 184 anëtarë sa ka Këshilli.

Lëvizja Vetëvendosje (LVV) nuk ka forum të gruas sipas modelit të subjekteve të tjera, por angazhimin e gruas e rregullon përmes sekretariateve të gruas aktiviste në secilin nivel të organizimit. Mungesën e forumit, LVV e arsyeton me atë se trajtimi i burrave dhe grave duhet të bëhet në mënyrë të barabartë, në varësi të kontributit të tyre. Në pozitat drejtuese, kjo parti ka një grua nënkryetare dhe një grua sekretare organizative, por çalon sa i përket përfshirjes së grave në nivele tjera drejtuese. Vetëm 4 nga 33 degët e kësaj partie drejtohen nga gratë, kurse vetëm 7 gra përbëjnë kryesinë e saj 23 anëtarëshe.

Nisma Socialdemokrate (NISMA), sikurse edhe shumica e subjekteve, çështjen e pjesëmarrjes së barabartë gjinore nuk e rregullon me kuota por vetëm me organizatën e veçantë të gruas (Organizata Nisma e Gruas për Kosovën). Kurse rreth përfaqësimit aktual të grave në organet e saj drejtuese nuk ka ndonjë informacion në faqen e tyre zyrtare. E njëjta vlen edhe për Aleancën Kosova e Re (AKR) dhe njësoj, as ky subjekt nuk parasheh kuota gjinore dhe çështjen e përfshirjes së gruas e trajton përmes Forumit të Gruas së AKR-së.

Të vetmet subjektet politike në Kosovë që në kuadër të statutit të tyre aplikojnë kuota gjinore janë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD). Kjo e fundit që nga themelimi i saj në vitin 1990, e ka të përcaktuar me statut që të gjitha organet drejtuese, ku përfshihen Këshilli Drejtues dhe Kryesia duhet të kenë përfaqësim minimal prej 40 përqind të secilës gjini. (kosovo two point zero, 2019).

4. Metodologjia

Ajo që ka ndryshuar më shumë gjatë këtyre pesëdhjetë vjetëve të fundit në vendet anëtare të Këshillit të Europës është pozita e gruas. Transformimi i marrëdhënieve gjinore në Europë është zhvillimi më revolucionar i marrëdhënieve shoqërore në historinë njerëzore (Woodward, 2001, f.8).

Aspirata e femrës për të luajtur rol në politikë është e hershme, por ky synim ende mbetet sfidues. Me aplikimin e sistemit të kuotave pjesëmarrja e gruas në politikë është rritur, megjithatë qasja e saj në vendimmarrje mbetet e izoluar (epoka e re, 2021, f.3). Partitë politike do të rrisin performancën e tyre në votime me të kuptuar më mirë çështjet me rëndësi për votuesit femra dhe duke zhvilluar platforma të fushatës dhe agjenda të qeverisjes për trajtimin e tyre. • Partitë politike duhet të ndërmarrin kërkime mbi modelet e votimit të grave për të kuptuar preferencat e grave, çështjet prioritare, qëndrimet dhe trendët. Hulumtimet duhet të fokusohen gjithashtu në kandidatet femra - pse ato kandidohen dhe pengesat që ato hasin - rolin e shoqërisë civile në mbështetjen e grave, dhe perceptimet publike të grave në politikë. Hulumtim i tillë do t'u mundësojë partive që të zhvillojnë strategji më efektive zgjedhore. • Të dhënat të zbërthyer për sjelljen e votuesve në baza gjinore duhet t'i ofrohen publikut nga KQZ-ja në kohën e duhur dhe në formate të përshtatshme digjitale.

Që nga zgjedhjet e fundit në vitin 2017, të gjitha 38 komunat e Kosovës udhëhiqen nga burra. Raportet aktuale tregojnë se janë vetëm dy gra nënkryetare (Suhareka dhe komuna e Zubin Potokut). Gjithashtu, 12 komuna emërojnë nënkryetarët për komunitete, nga të cilat 3 janë gra (Klllokot, Mamushë dhe Prizren). Në pozitat e larta vendimmarrëse me drejtoritë komunale, përfaqësimi i grave është rritur gjatë viteve. Në vitin 2017 ishte 18.54%. Në vitin 2018, nga 364 drejtorë në zyrat komunale, gratë përbëjnë 72 ose 19.83% (INDEP, 2019, f.12)

Partitë duhet të bëjnë rekrutimin e kandidatëve në kohë të mjaftueshme nga koha kur priten zgjedhjet e ardhshme. Përzgjedhja e kandidatëve duhet të jetë formale, e formuluar në mënyrë të qartë dhe transparente. Partitë politike duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për të mbajtur gratë në kandidim për postet e ardhshme, veçanërisht gjatë cikleve jo-zgjedhore duke përfshirë gratë në aktivitete të tilla si programet e trajnimit, tryezat e rumbullakëta për diskutim të politikave dhe në ngjarje të partive në nivele degësh. Mirëpo, e pranoi ose jo shoqëria, në

Kosovë kemi asambleiste, ministre, deputete të zonja, ndërsa në legjislaturën e fundit, Kuvendi i Kosovës drejtohet nga një femër, Vjosa Osmani, e cila në zgjedhjet e fundit parlamentare ishte femra më e votuar duke marrë gjithsej 176 mijë e 16 vota, e tani është edhe kryetare e shtetit. Edhe në vitin 2011, me vetëm tre vite shtet, Kosova udhëhiqej nga një presidente femër, Atifete Jahjaga (kosova live, 2021, f.4).

4.1 Rëndësia e trashëgimisë politike dhe institucionale mbi progresin politik të grave

Kur gratë janë të fuqizuara si udhëheqëse politike, ato vende zakonisht shkojnë drejt standardeve më të larta të jetesës dhe zhvillimeve pozitive në arsim, infrastrukturë, dhe shëndetësi. Zgjerimi i pjesëmarrjes në politikë me përfshirjen e grave mund të përmirësojë funksionimin e qeverive, legjislativit dhe partive politike, dhe mund të ndihmojë qeveritë të sigurojnë përfitime më të prekshme për qytetarët

Parimet e Prishtinës, të dala nga Samiti Ndërkombëtar për Fuqizimin e Grave organizuar nga presidentja Atifete Jahjaga më 2012 dhe e mbështetur nga USAID, thotë se “nënperfaqësimi politik i grave cenon njohjen e shoqërisë me problemet ekonomike, të sigurisë, drejtësisë dhe ato sociale me të cilat ata përballen, dhe gatishmërisë së qeverisë që me të vërtetë t’i trajtojë ato problemeiii. Zgjerimi i pjesëmarrjes së grave në politikë çon në përfitime të prekshme për qeverisjen demokratike. Pjesëmarrja e plotë dhe aktive e grave në politikë rezulton në përfitime pozitive duke përfshirë edhe zhvillimin e politikave që janë më të përgjegjshme ndaj nevojave të qytetarëveiv, rritjen e bashkëpunimit përmes linjave partiave, dhe paqe më të qëndrueshme (NDI, 2015, f.8)

Në pamundësi të të qenit aktere të rëndësishme në skenën “e madhe”, gratë gjejnë zgjidhje në krijimin e “minihapësirave” brenda strukturave të mëdha të fushave të caktuara. Për shembull, gratë kanë forumet e tyre brenda partive politike të cilat iu mundësojnë një autonomi në aktivitetin e tyre, ashtu si edhe mediat që ndajnë hapësirë për emisione/ rubrika të veçanta që i kushtohen ekskluzivisht grave. Forumet e grave në parti politike dhe hapësirat e tyre mediale shpeshherë nuk shkojnë më thellë se trajtimi i çështjeve si barazia gjinore, dhuna në baza gjinore, pjesëmarrja e grave në politikë, çështjet e familjes, karrierës së grave, modës, etj. Për këtë arsye,

“hapësirat e paracaktuara” politike dhe mediale bartin me vete edhe rrezikun e marginalizimit socio-politik dhe mediatik të grave dhe vajzave, por edhe mund të ndikojnë negativisht në demokratizimin e shoqërisë (QKSG, 2009, f.37).

Shumë gra e perceptojnë ambicien politike si një ftesë për hetim publik të jetës së tyre private, e që do të kishte ndikim të drejtpërdrejt në familjet e tyre. Shumica e grave kanë një kuptim pragmatik për nevojën e një përkushtimi të fortë për të kandiduar për poste publike dhe të vendimit për të ndërmarrë sakrifica të rëndësishme në jetën e tyre personale dhe profesionale që kërkohet nga kandidatët për poste politike. Përveç kësaj, disa të intervistuar thanë se gratë ngurrojnë për të ndjekur një karrierë në politikë për arsye ekonomike, pasi që për t’u bërë kandidat mund t’u kërkohet që të heqin dorë nga puna e tyre. Një identitet partizan mund të jetë i dëmshëm për karrierën e grave. Në të gjitha rastet, femrat që kanë hyrë në politikë varen nga mbështetja e familjeve të tyre në mënyrë që të tejkalohen pengesat e shumta (NDI, 2015, f.13).

Njëra ndër sfidat më të mëdha të grave politikane në Kosovë është krijimi i raporteve të nevojshme të komunikimit me votuesit. Për shkak të arsyeve të ndryshme (mungesa e grave në hierarkinë e institucioneve dhe partive politike, mungesa e përkrahjes financiare për gratë kandidate, marginalizimi i grave politikane brenda çështjeve të përcaktuara paraprakisht, si barazia gjinore ose çështjet tjera që kanë të bëjnë me gratë, etj.), gratë politikane e kanë më të vështirë që ta sigurojnë hapësirën e duhur mediale, që është njëri prej aspekteve kryesore të komunikimit me publikun. Hapësira mediale, përfshirë debatet, intervistat, edicionet informative, si dhe prezantimi i programit dhe kandidatëve partiakë, gjatë fushatës zgjedhore dominohet nga politikanët burra (QKSG, 2009, f.60).

Në këtë pjesë, është e rëndësishme të zhvillohet lidhshipi i grave. Pra Partitë politike duhet të hulumtojnë mundësitë për të siguruar që në vazhdimësi të jepen trajnime për zhvillimin e aftësive për gratë anëtare. • Partitë duhet të sigurojnë trajnime për aftësitë e qeverisjes për gratë dhe burrat duke paraparë pozitave udhëheqëse. • Partitë duhet të ndërmarrin masa që të sigurojnë mundësi politike për gratë jashtë posteve, si caktimi nëpër poste ekzekutive në nivel lokal dhe kombëtar, në postet e lidhshipit partiak, dhe në postet e qeverisjes lokale.

4.2 Roli i grave në pozita vendimarrëse në parti, institucione publike në nivel qendror dhe lokal

Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë konsiderohet të jetë e vogël përkundër kërkesës ligjore nga Ligji Nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 6, pika 8, që thekson se përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse(QKSG, 2021, f.9).

Që të arrihet një pjesëmarrje kuptimplote e grave në politikë kërkon ndërtimin e kapaciteteve të grave kandidate, duke rritur hapësirën brenda partive politike dhe duke nxitur vullnetit politik mes udhëheqësive partiake. Këtë mund ta ndajmë në tri kategori, në vijim: 1) Rritja e kapaciteteve të partive për të mbajtur gratë: Partitë nuk janë në gjendje të tërheqin gratë si anëtare të partisë dhe nuk zhvillojnë dhe mbajnë gratë përmes programeve të zhvillimit të lidërsipit. 2) Rritja e hapësirës për gratë: Strukturat partiake vendim-marrëse dhe pozitat udhëheqëse në nivel kombëtar dhe në degë janë të paarritshme për shumicën e grave. Përveç kësaj, partitë nuk kanë vullnet dhe aftësi për të krijuar hapësirë për gratë kompetente dhe të talentuara. Ka pak mundësi për gratë të mbajnë pozita partiake ose qeveritare, e kjo do të mund të nxiste vlerësim më të madh për kontributin e grave në partitë e tyre. 3) Vullnet më i madh politik për të krijuar pjesëmarrje domethënëse të grave: Për shembull, të gjithë liderët e partive politike pranojnë të mirën e kuotës gjinore, por këtë kuotë e përcjellin më tepër në letër se në frymen e saj. Partitë shpesh gratë nuk i marrin seriozisht si anëtare, udhëheqëse apo kandidate. Shumë shpesh, partitë i rekrutojnë gratë thjesht për të përmbushur kërkesat minimale ligjore për kuotat.(NDI, 2015, f.6-7).

Megjithatë, shumica e njerëzve të intervistuar, duke përfshirë gratë kandidate në zgjedhjet e fundit, nënvizojnë zgjedhjen e kryetares së komunës grua dhe rritjen e grave kandidate të zgjedhura pa kuota, si dëshmi se kjo situatë është duke u përmirësuar ngadalë, kryesisht për shkak të një numri më të madh të grave në role udhëheqëse, e kjo është duke ndihmuar për të ndërruar qëndrimet (NDI, 2015, f.15).

Megjithatë, ekipi vlerësues nuk ka gjetur prova për bashkëpunim spontan apo mbështetje për gratë në politikë nga gratë në biznes, në media dhe në shoqëri civile. Do të dukej se

përkundër rritjes së numrit të grave që janë tani në skenën politike në Kosovë, pengesat për bashkëpunim mes grupeve të grave të ndryshme në shoqërinë kosovare ekzistojnë. P.sh. nëse ndalemi tek Përfaqësimi i grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe institucioneve e agjencive të pavarura është shumë i ulët. Nga 159 anëtarë të bordeve në 31 ndërmarrje publike, 135 janë burra dhe 24 gra. Vetëm pesë borde kryesohen nga gratë. Nga 184 anëtarë të bordeve në 31 institucione dhe agjenci të pavarura, 149 janë burra, 30 janë gra dhe për pesë anëtarë nuk ka informacione. Pozita e kryesuesit/es së bordit ushtrohet në 23 raste nga burrat, në tri raste nga gratë dhe për pesë raste tjera nuk dihet pasi që ato borde aktualisht nuk kanë kryesues (GAP, 2017, f.3).

Për të ndryshuar gjendje dhe për tu vlerësuar grate në politikë, duhet të gjitha partitë politike të sigurojnë përfaqësim më të madh të grave në strukturat partiake, sidomos në nivelet e degëve dhe të miratojnë deklaratë të qartë për barazi gjinore, në përputhje me standardet ndërkombëtare, psh. në nivel dege, zëvendëskryetarët duhet të jenë të gjinisë tjetër nga ajo e udhëheqësve të degëve; Partitë duhet të konsiderojnë miratimin e rregulloreve për t'i parandaluar individët nga mbajtja e shumë posteve dhe pozitive udhëheqëse në strukturat e tyre, në mënyrë që të ketë më shumë hapësirë për gratë dhe të rinjtë; Partitë duhet të hulumtojnë drejtimitet e qasjes në mënyrë që të sigurojnë balancë gjinore në radhët e udhëheqjes, duke reflektuar në praktikatat e familjeve përkatëse partiake evropiane; Selitë e partive duhet të inkurajojnë përfaqësim më të madh të grave në udhëheqësitë e degëve duke i komunikuar përfitimet e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe duke avancuar institucionalizimin e praktikave më gjithëpërfshirëse në leadership në nivelet e degëve.

4.3 Politikanet gra nëpër botë dhe fuqia e tyre

Këtë pjesë të punimit po e nisim me Platformën për Aksion e Pekinit e viti 1995 në Kombet e Bashkuara), dhe me zotimin e saj për fuqizimin e gruas, që është edhe deklarata më e fuqishme ndërkombëtare deri tani për nevojën themelore të balancës gjinore në marrjen e vendimeve, e që bazohet në bindjen se: Fuqizimi i gruas dhe pjesëmarrja e plotë saj mbi bazën e barazisë në të gjitha sferat e shoqërisë, përfshirë këtu pjesëmarrja në procesin e marrjes së vendimeve dhe e aksesit në pushtet, janë themelore për arritjen e barazisë, zhvillimit dhe paqes (Woodward, 2011, f.10).

Historikisht politikanet femra nuk janë vetëm kandidatë të duhura për një vend pune, por edhe femra tek të cilat mund të besosh verbërisht që të drejtojnë “timonin” e një shteti. Të ardhura nga formime dhe profesione të ndryshme, ato kanë treguar se dinë të përballojnë mirë presionin dhe përgjegjësinë për të nxjerrë një vend nga kriza dhe për t’ua bërë jetën më të sigurt dhe më të mirë njerëzve që i votojnë. Megjithatë, avancimi dhe fuqizimi i tyre në pozitat vendimarrëse varet shumë edhe nga lloji i sistemit politik dhe ekonomik të një shteti. Kështu për shembull, shtetet me sistemin social demokrat dhe ekonomi sociale të tregut siç janë Gjermania dhe vendet nordike, ofrojnë programe të mbështetjes më të mëdha sociale. (Matoshi and Mulaj, 2019, f.180-191). Si rezultat, edhe roli i grave në pozitat udhëheqëse të këtyre shteteve është më i madh se në shtetet tjera.

Në vitin 2011, Kuvendi i Kosovës emëroi presidenten e parë grua duke e bërë Kosovën një nga vendet e para në rajon që t’i besojë detyrat presidenciale një gruaje. Gjatë kësaj kohe, numri i grave të përfshira në pozita këshilluese ishte e barabartë me numrin e burrave. Megjithatë, aktualisht Presidenca e Kosovës nuk ka gra të emëruara në pozita të larta vendimarrëse ose si këshilltarë të Presidentit . Kjo tregon se gratë në pozita udhëheqëse politike u besojnë grave të tjera për të marrë pozita vendimarrëse. Megjithatë, situata ndryshon kur burrat i marrin ato pozita, pasi ata preferojnë të caktojnë burra në pozitat që merren me vendime të rëndësishme(INDEP, 2019, f.6).

Ne e kujtojmë Margaret Thatcher, një prej femrave që la gjurmë në histori për pushtetin dhe karakterin e fortë. E ashtuquajtura “Zonja e Hekurt”, Thatcher shembi tabutë dhe i tregoi mbarë botës se femrat mund të ishin po aq të afta sa dhe meshkujt për të mbajtur përgjegjësi aq të mëdha mbi supe.

Me kalimin e viteve e kryesisht përgjatë kohëve të fundit, në arenën politike ndërkombëtare femrat lidere sa vijnë e shtohen. Në lidhje me këtë fenomen, pak muaj më parë, revista prestigjioze ‘Forbes’ klasifikoi femrat më të fuqishme të botës për vitin 2012, të cilat vijnë nga fusha e politikës. Me tepër se një renditje, ‘Forbes’ evidentoi edhe ndryshimet dinamike të përfshirjes së grave në politikë. Kryesuesja e listës së femrave më të pushtetshme në botë ishte kancelarja gjermane Angela Merkel, e cila u bë e famshme për “dorën e fortë” që i dha jo vetëm Republikës Federale Gjermane, por edhe të gjithë vendeve në krizë të Eurozonës. Merkel u ndoq në këtë renditje nga ish-sekretarja amerikane e shtetit, Hilary Clinton. Clinton,

njëkohësisht ish-Zonja e Parë e Amerikës, u bë e njohur për politikën e ndjekura përtej detit, kryesisht në kontributin dhënë për ndihmën ndaj grave dhe çështjet e zhvillimit dhe arsimit, të cilat e çuan në majë axhendën e politikave të jashtme. Dilma Rousseff, presidentja e Brazilit, u rendit në vendin e tretë, për meritat e veçanta që dha në rimëkëmbjen dhe forcimin e ekonomisë vendase. Me profesion ekonomiste, ish-guerrilasja marksiste mbështeti iniciativat e biznesit të vogël dhe projektet madhore të infrastrukturës, që e çuan vendin drejt një ere të re zhvillimi. (top channel)

Nga literatura mësojmë se gratë politike ngrihen më tepër në piadestal kur e fillojnë karrierën politike por edhe u nënshtrohen kritikave më të shumta në rast të dështimit në politikë. Gratë politike udhëheqëse, për shembull i nënshtrohen më tepër një rishikimi të kujdesshëm (apo gjykimi) medial, to cilat i atribuohen prirjes së mediave ndaj stereotipeve gjinore të cilat i favorizojnë burrat në raport me gratë në pushtet. (Heather, 2013, f.100).

4.4 Sfidat politike, ligjore, kulturore

Përfaqësimi i drejtë dhe pjesëmarrja e grave dhe burrave në jetën publike është me rëndësi kritike për barazinë gjinore. Një përfaqësim i barabartë përmirëson i) legjitimitetin e demokracisë, duke u dhënë mundësi grave të marrin pjesë në çështjet publike, ii) drejtësinë, duke marrë vendime të drejta politike që marrin parasysh nevojat e grave, iii) transparencën, duke qenë të hapur dhe marrjen e inputeve nga gratë gjatë kryerjes së politikave vendimet dhe iv) rezultatet gjithëpërfshirëse të politikave, duke marrë parasysh nevojat e secilit, përfshirë këtu gratë (INDEP, 2019, f.4).

Reforma gjithëpërfshirëse zgjedhore dhe rritja e pjesëmarrjes së grave në proceset politike do të paraqesë mundësi të rëndësishme për Kosovarët për të forcuar besimin në sistemin politik. Për këtë Avokati i Popullit u rikujton subjekteve politike se Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, respektivisht neni 14 i tij, shprehimisht thotë: “Partitë politike me aktet e tyre obligohen të zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të meshkujve dhe femrave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji. (<https://sbunker.net/>, 2019, f.2).

Realisht, gratë në komunitetet e pakicave përballen me sfida edhe më të mëdha kulturore për të marrë pjesë në politikë, duke përfshirë rezistencë më të madhe kulturore ndaj grave në politikë, si dhe mungesës së mundësive të arsimimit dhe të punësimit (NDI, 2015, f.6).

Gratë ndikojnë në zhvillimin e politikave që përfshijnë një qasje më të barabartë gjinore; ato mund të bëjnë shumë punë njëkohësisht, janë kreative dhe shpesh më pak të korruptuara kur mbajnë pozita të vendimmarrjes. Në përgjithësi, pjesëmarrësit e fokus grupeve konsiderojnë se gratë kanë aftësi të shkëlqyera udhëheqëse dhe pranojnë se gratë duhet të jenë më të pandashme në kërkimin e të drejtave të tyre dhe avancimin e rolit të tyre në proceset e vendimmarrjes në vend (INDEP, 2019, f.17).

Mendojë që sfidat vazhdon të jenë të pranishme dhe shteti duhet të veprojë në lidhje me: Të ndërmerret një shqyrtim i ligjit zgjedhor dhe ligjit për barazi gjinore dhe zbatimit të tyre për të siguruar pjesëmarrjen politike të grave më të madhe dhe më efektive. Ligji për barazi gjinore dhe ai zgjedhor dhe çdo propozim për ligjet që qeverisin partitë politike duhet të jenë në përputhje. Kjo kornizë ligjore duhet të përfshijë sanksione dhe dënime të zbatueshme. • Të mbështetet synimi i kuotës gjinore si një mekanizëm për përfaqësim të barabartë dhe një njohje publike për përfitimet që ka dhënë kjo kuotë duke vendosur gratë në poste politike dhe në ndryshimin e qëndrimeve ndaj grave. Partitë duhet të përqafojnë frymën e kuotës gjinore duke zhvilluar strategji për të rekrutuar dhe mbajtur gratë si anëtare të partive, me përgatitjen dhe mbështetjen e tyre për të kandiduar si kandidatë të suksesshme, dhe duke mbështetur gratë si udhëheqëse në parti dhe në qeveri. Organizatat e shoqërisë civile duhet të monitorojnë zbatimin e kuotave gjinore, si dhe efektet e saj.

Mentaliteti patriarkal i një pjese relativisht të madhe të shoqërisë, është një burim tjetër i karakterit sipërfaqësor të pjesëmarrjes së grave në politikën kosovare. Përgjatë zgjedhjeve që janë mbajtur pas shpalljes së pavarësisë, statistikave tregojnë se në raport me pjesëmarrjen në lista zgjedhore, gratë, (mesatarisht) votohen shumë pak në krahasim me burrat. (balkans group, 2020, f.1).

Çështja e besimit qytetar që gratë e gëzojnë pak, në raport me burrat, është problem që i ka rrënjët ndoshta në edukimin fillestar, frymën patriarkale në të cilën jemi rritur, sistemin arsimor, e shumë të tjera. Të gjitha këto shkaqe, kanë ndikuar në krijimin e perceptimit të gabuar

të qytetarëve kosovarë ndaj grave në politikë. Megjithëse këto probleme janë ende shumë të dukshme, viteve të fundit, shohim disa shkëndija të vogla që na bëjnë të shpresojmë se më në fund, gratë në politikën kosovare do ta kenë vendin e merituar. Ndonëse jo si tërësi, në përmasa individuale, në vitet e fundit shohim një rritje të vogël të votave që marrin gratë në zgjedhje elektorale. Kjo rritje e votave mund të shërbejë si parametër që tregon se qytetarët e Kosovës dalëngadalë kanë filluar të iu besojnë grave për përfaqësimin politik të tyre (Po aty, f.2).

Sfidat me të cilat ballafaqohen gratë kur marrin pozita udhëheqëse, të cilat janë mungesa e mbështetjes nga familja, nga kolegët në parti të politike, nga stigma shoqërore ndaj grave dhe në përgjithësi nga një kulturë pune që e vë burrin të parin në të gjitha sferat e jetës. Detyrat familjare, kujdesi për fëmijët, mungesa e pushimit prindëror dhe mundësitë e kufizuara për programet profesionale për të mbështetur aftësitë udhëheqëse dhe të menaxhimit të grave janë sfida të tjera që ndikojnë aftësinë e grave për të arritur rolet vendimmarrëse. Përveç kësaj, roli i partive politike në emërimin e pozitave vendimmarrëse mbetet si një nga sfidat më të mëdha që lidhshipi ka tendencë ta shohë burrin si një përshtatje më të mirë për pozita të tilla.

4.5 Rëndësia e mediave për imazhin dhe faktorizimin e grave në skenën politike kosovare

Femrat në politikë është e rëndësishme të ndërtojnë një profil të fuqishëm publik dhe medial. Në çdo shembull, gratë kandidatë të cilat kanë qenë të suksesshme në tërheqjen e një numri të madh të votave i falënderohen profilit të tyre medial dhe aftësive superiore të komunikimit, si faktor të mëdhenj në suksesin e tyre.

Mbi këtë duhet të themi që Mediat janë ato që e bëjnë përzgjedhjen e çështjeve të cilat do të përfshihen në diskutet publike dhe në këtë mënyrë ndikojnë në krijimin e opinionit publik. Roli i mediave në pasqyrimin e roleve gjinore është i një rëndësie parësore, pasi prej tyre varet nëse këto role do të analizohen në mënyrë të plotë dhe kritike, apo trajtimi i tyre do të bëhet duke u mbështetur në stereotipa të trashëguar nga e kaluara (QKSG, 2009, f.33).

Ndonëse nuk ka analiza të hollësishme për mediat në Kosovë, prapëseprapë mund të thuhet se ato ushqejnë imazhe stereotipe për gratë dhe nuk e sjellin imazhin real të roleve të shumëfishta kualitative të grave në jetën shoqërore dhe politike. Mediat duhet ta korrigojnë

qasjen aktuale ndaj grave dhe të ndikojnë në përplotësimin e imazhit të gruas, gjë që do të ndikonte në arritjen e barazisë gjinore (QKSG, 2009, f.33).

Problemi i profileve joadekuate publike është i përbërë nga mungesa e mundësive të mediave për gratë kandidatë, përmes të dyja mënyrave: mundësive mediale që ju është dhënë nëpërmjet ngjarjeve të ndryshme dhe kohës së paguar në media nëpërmjet partive të tyre. Raporti Preliminar i Misionit Vëzhgues i Zgjedhjeve i Bashkimit Evropian vë në dukje se, “Partitë politike vazhdojnë të dominohen nga meshkujt dhe mediat japin mbulim shumë më të gjerë për kandidatët meshkujxvii“. Një tjetër raport vëzhgimi për zgjedhjet e vitit 2014 nga ana e Demokracisë në Veprim vuri në dukje se pjesëmarrja e grave në ngjarjet e fushatës ishte thjesht “simbolike”, pasi që gratë përbënin vetëm 5 për qind të pjesëmarrësve(NDI, 2015, f.14).

Gjatë një fushate 10-ditore, ka pak mundësi për gratë për të marrë pjesë në debate. Ndërkohë që mediat u kërkuan partive që të dërgojnë një kandidatë femër në dy kandidatë meshkuj për debate, në shumicën e rasteve, partitë dërguan kandidatët meshkuj më me përvojë për të përfaqësuar partitë në televizion. Mungesa e mbështetjes dhe e ekspozimit ishte një faktor kritik për mungesën e suksesit të kënaqshëm zgjedhor për gratë (NDI, 2015, f.14-15).

Mediat vënë shumë presion mbi gratë në pozitat vendimmarrëse. Gratë janë kryesisht të përfaqësuara në debate për çështjet e grave, por jo për vendime të mëdha për shtetin, institucionet etj. Gratë komentohen për pamjen, veshjen dhe shumë pak për sferën profesionale dhe rezultatet e arritura (INDEP, 2019. f.16).

Ekipi gjeti mendime të ndryshme për nivelin e diskriminimit në media dhe të stereotipizimit që ekziston në mediat kosovare. Në shumë raste, kundërshtarët përdorën moshën dhe gjininë e grave si argumente kundër kandidaturës e tyre. Të dhënat për votimet nga UNDP-ja konfirmojnë se popullsia e përgjithshme ka tendencë që të lidhë meshkujt me poste politike dhe shumë prej të intervistuarve thonë se votuesit priren të favorizojnë burrat karshi grave si kandidat. Modelet e votimit nga dy zgjedhjet e fundit mbështesin argumentin se qytetarët janë më shumë të prirë të japin votën e tyre për një burrë se sa për një grua kur hedhin vota preferenciale.(NDI, 2015, f.15).

Mendojmë që ëshë e nevojshme të rritet mbështetja në fushatë për gratë kandidatë:

- Lidërshipi politik i partive duhet të dedikojë burime të barabarta për gratë kandidate, duke përfshirë mbështetje në njerëz dhe atë financiare, ekspozimit në media dhe të natyrave të tjera.
- Shoqëria civile, përfshirë mediat, duhet të ndërmarrin masa që aktivisht të angazhohen në edukimin e votuesve në ndjeshmëri gjinore dhe në përfitimet nga pjesëmarrja e grave në politikë.
- Partitë politike duhet të sigurojnë lidërshp të balancuar gjinor në mitingje, takime, dhe paraqitje mediale.

5. Përfundime

Pozita e gruas kosovare me gjithë evolucionin politik, social, material, kulturor, vazhdon të jetë aty ku nuk duhet, pra në pozitë jo të mire. Konkurrenca midis grave në vendimmarrje dhe brenda strukturave politike është shumë e kufizuar, madje shpesh ndikon në çështjet e cilësisë dhe profesionalizmit për vendime të caktuara vendimmarrëse. Kjo kryesisht për shkak të interesit të lidershit politik për të favorizuar gratë që janë më lehtë të menaxhueshme, në vend të grave që sjellin udhëheqësi të fortë dhe profesionale.

Sistemi dhe kultura aktuale politike nuk i përkrah gratë. Kjo për shkak për emërime në pozita vendimmarrëse, meshkujve u jepet përparësi kundrejt grave. Për më tepër, kultura e punës së marrjes së vendimeve të rëndësishme në vende të tjera, përveç zyrave, përjashton gratë nga biseda të rëndësishme, si dhe i bën ato të duken të papërshtatshme për të mbajtur një pozitë vendimmarrëse.

Vendimet e mëdha merren nga burrat në qeveri, në oda, në kafene dhe në vende të tjera jashtë zyrës, dhe kjo krijon pengesë për gratë që të jenë pjesë e vendimmarrjes. Burrat bashkohen në mjedise të tilla me kolegë burra nga partitë e tyre, duke bërë atributë publike ndaj paragjykimëve të grave për moralin etj.

Vendosja e kuotës për përfaqësimin e grave në kuvend ka treguar efekt dhe si rezultat i kuotës në lista zgjedhore, gjithnjë e më shumë gra hyjnë në kuvend duke marrë vota më shumë se burrat, megjithatë prania e kuotës nuk po nëkupton domosdoshmërisht edhe zgjidhjen e problemeve dhe sfidave me të cilat po ballafaqohen gratë në Kosovë.

Ashtu sikurse në politikë dhe përgjithësisht në politikë-bërje, gratë nuk janë mjaftueshëm të përfaqësuara as në nivelin lokal, përfshirë organet komunale, ndërmarrjet publike lokale, dhe ato rajonale, si dhe institucionet publike të shtetit.

Në vendet me demokraci të zhvilluar, çështjet gjinore më nuk janë thjesht çështje e grave dhe burrave, por kanë të bëjnë më të drejtat e njeriut dhe garantimin e barazisë për të gjithë njerëzit, përfshirë edhe grupet e marginalizuara. Prandaj mediat kosovare dhe mekanizmat institucionalë që e rregullojnë funksionimin e peizazhit mediatik duhet të vetëdijesohen për faktin se ndjeshmëria ndaj mënyrës së prezantimit të grave politikane në media është segment shumë i rëndësishëm për procesin e demokratizimit të shoqërisë.

E vërteta është që pjesëmarrja dhe roli i grave në politik dhe në pozitat vendimmarrëse kontribuon në forcimin institucional dhe në zhvillimin e demokracisë. Për më tepër, besohet se gratë ndikojnë në zhvillimin e politikave që përfshijnë një qasje më të barabartë gjinore; ato mund të bëjnë shumë punë njëkohësisht, janë kreative dhe shpesh më pak të korruptuara kur mbajnë pozita të vendimmarrjes. Në përgjithësi, konsiderohet se gratë kanë aftësi të shkëlqyera udhëheqëse dhe pranojnë se gratë duhet të jenë më të pandashme në kërkimin e të drejtave të tyre dhe avancimin e rolit të tyre në proceset e vendimmarrjes në vend.

Përfundimisht të gjithë akterët relevant brenda shoqërisë kosovare duhet të punojnë për barazinë gjinore si çështje strategjike e që përmes saj duhet të bëjnë të pamundurën që grate të jenë jo vetëm pjesëmarrse por edhe të kenë rol e ndikim të madh në të gjitha instancat publike të politikës.

6. Bibliografia

- Alison E. Woodward, (2011). Të ecësh drejt balances gjinore. Strasburg.
- Bajrami, A. (2010). Parlamentarizmi, Aspekte Krahasuese. Kolegji Fama. Prishtinë.
- Bajrami, K.(2001). Koncepte për mendimin e ri politik. Multigraphics.Prishtinë
- Beha , A.(2017). Mes stabilitetit dhe demokratizimit.Zgjedhjet, partitë politike dhe demokracia brendapartiake në Kosovë. CPC & FES. Prishtinë.
- Haziri, B.(2017). Kultura politike e Kosovës. Toena. Tiranë.
- Instituti GAP, (2017). Përfaqësimi i grave në bordet e ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura.
- Instituti për Politika Zhvillimore INDEP, (2019). Gratë në vendimmarrje në institucionet publike në Kosovë. Prishtinë.
- Krasniqi, A & Shala, K. (2012). Fuqizimi i shtetësisë së Kosovës nëpërmjet demokratizimit të partive politike. KIPRED. Prishtinë.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, (2008). Prishtinë.
- Lijphart, A. (1985). Multiethnic Democracy‘ në Seymour Martin Lipset. The Encyclopedia of Democracy. Washington.
- Matoshi, Ruzhdi and Mulaj, Isa (2019). Social Market Economy as an alternative to the Washington Consensus in the Western Balkans, Vol. 6, No. 11-12. Economic Vision.
- McIntosh, Heather, (2013). Women and politics in the media. Canada.
- Mulaj, Isa (2010), “Self-management Socialism compared to Social Market Economy in Transition: Are there Convergent Paths?” in Seliger, Bernhard, Juri Sepp and Ralph Wrobel eds., Chancen und Risiken für die Soziale Marktwirtschaft im internationalen Wettbewerb der Wirtschaftssysteme, Vol. 2, Peter Lang, Frankfurt.

National Democratic Institute, (2015). Kosovë: Tejkalimi i Pengesave për Pjesëmarrjen e Grave në Politikë. Prishtinë.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, (2009). Imazhi i Grave Politikane në Mediat Kosovare. Prishtinë.

Qendra Kosovare për Studime Gjinore, (2017). Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në Kosovë. Prishtinë

UNMIK, (2018). Raport përmbledhës, Dita globale e OKB-së për gratë, paqen dhe sigurinë. Prishtinë.

Zogjani, V, (2013). Hulumentim: Pozita e femrave në procesin e vendimmarrjes në Kosovë. Prishtinë.

Zyra e Kryeministrit, (2014). Raporti i hulumentimit - Pjesëmarrja, roli dhe pozita e grave në institucionet qendrore, lokale, dhe në partitë politike në Kosovë. Prishtinë

6.1 Burime nga Interneti

<https://balkansgroup.org/roli-i-grave-ne-perfaqesimin-e-qytetareve-te-republikes-se-kosoves/>

<https://kdi-kosova.org/programet/fuqizimi-i-gruas-ne-politike-dhe-vendimmarrje/>

<https://kosovalive.org/2021/01/28/grate-ne-poste-politike-fale-vetem-kuotes-gjinore/>

<https://kosovotwopointzero.com/gender-inequality-is-still-pervasive-in-decision-making-and-politics/>

<https://sbunker.net/destrata-blllogje-tematike/89574/pjesemarrja-e-ulet-e-gruas-ne-politike-faktoret/>

<https://sbunker.net/op-ed/90331/sfidat-e-zbatimit-te-ligjit-per-barazi-gjinore-ne-kosove/>

<https://top-channel.tv/2013/04/23/femrat-ne-politike/>

<https://www.epokaere.com/kuotat-dhe-fuqizimi-grave-ne-politike/>

<https://www.evropaelire.org/a/kuota-gjinore-grate-parlamenti/31047004.html>